



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
BAZAT E KOMUNIKIMIT NË INSTITUCIONE DHE NDËRMARRJE

Ngarkesa: 6 kredite, 60 orë mësimore: 20 leksione / 40 seminare

Moduli 1: Baza konceptuale të komunikimit

Moduli 2: Komunikim i brendshëm dhe i jashtëm në ndërmarrje dhe institucione

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Viti I / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyruar

Programi i studimit: Programi i studimit profesional dyvjeçar në “Komunikim shumëgjuhësh në Institucione dhe Ndërmarrje”

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (Nenet 4, 5, 6, 7)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e lëndës (Moduli 1 dhe Moduli 2 të integruar): Njohuri, Aftësi, Kompetenca:

- Të kuptojnë teoritë bazë të komunikimit dhe zbatimin e tyre në praktikë.
- Të analizojnë marrëdhëniet ndërpersonale dhe institucionale përmes prizmit të komunikimit efektiv.
- Të identifikojnë dhe të menaxhojnë sfidat në procesin e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm.
- Të zhvillojnë aftësi për të hartuar strategji komunikimi në përputhje me qëllimet institucionale apo të ndërmarrjes.
- Të reflektojnë në mënyrë kritike mbi ndikimin e kulturës organizative dhe teknologjisë në procesin e komunikimit.

Rezultatet e të nxënit

Moduli 1: Baza të komunikimit

Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje të:

- Përshkruajnë konceptet dhe modellet themelore të komunikimit.
- Analizojnë elementët e procesit të komunikimit verbal dhe joverbal.
- Vlerësojnë rëndësinë e kontekstit kulturor dhe social në komunikim.
- Zbatojnë strategji të ndryshme të komunikimit në situata të ndryshme ndërpersonale dhe profesionale.

Moduli 2: Komunikim i brendshëm dhe i jashtëm në ndërmarrje dhe institucione

Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë format dhe kanalet e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm në organizata.
- Analizojnë sfidat dhe mundësitë e komunikimit institucional në mjedise shumëkulturore dhe digjitale.
- Përdorin mjete moderne për të përmirësuar rrjedhën e informacionit dhe imazhin publik të institucionit apo ndërmarrjes.

Moduli 1 dhe 2 të integruar

Në përfundim të gjithë lëndës, studentët do të kenë aftësinë të:

- Ndërtojnë strategji të integruara komunikimi që përfshijnë aspektet teorike dhe praktike të të dy moduleve.
- Marrin vendime të informuara mbi menaxhimin e komunikimit në situata të ndryshme organizative.
- Bashkëpunojnë në mënyrë efektive në grupe ndërdisiplinore për realizimin e projekteve të komunikimit.